



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr. **60/2024. Ora: 13:30**

Data: **08.11.2024**

Vendi: **Zyrat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi

Anëtarët e KQZ-së: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Qemailj Kurtis,

Në takim ishin të Mufera Shinik

pranishëm:

U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP: Besnik Buzhala

Përkthyes: Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Procesverbali i mbledhjes së KQZ Nr.58 dhe 59/2024

3 Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ

4. Aktivitetet e Zyrës

4.1 Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për regjistrimin e partisë politik BASHKIMI DEMOKRATIK

5. Raport i Këshillave të KQZ

5.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore

5.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së Qendrave të Votimit

5.1.2. Shqyrtimi dhe miratimi i Specifikave teknike për shtypjen e distinktivëve për procesin e Votimit për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025 dhe Zgjedhjet Lokale 2025

5.1.3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektit- Fushatë ndërgjegjësuese për promovimin e barazisë gjinore në proceset zgjedhore

5.1.4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të aktiviteteve për edukim dhe informim dhe materialeve të tjera

5.1.5. Formimin i Këshillit për Informim Publik

5.2. Këshilli për Personel

5.2.1. Njoftim lidhur me procesin realizimit të rekrutimit për pozitat e përhershme dhe të përkohshme

5.2.2. Shqyrtimi dhe aprovimi i listës së kandidatëve potencial për pozitën: Udhëheqësi i Njësisë për Regjistrim dhe Certifikim të Subjekteve Politike në ZRCKFSP

5.2.3. Rekomandim për themelimin e grupit punues për sistemim dhe digjitalizim të arkivës së KQZ-së

5.2.4. Shfuqizimi i Udhëzimit Administrativ 02/2015 për Arkivin dhe Lëndët Arkivore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

5.3. Këshilli për Çështje Ligjore

5.3.1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtari të kuvendit komunal në Pejë

5.4. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

5.4.1. Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ-së në konferencën “Informimi dhe angazhimi i votuesve – një perspektivë rajonale mbi sfidat dhe mundësitë për të rritur pjesëmarrjen në votime”, në Varshavë, Poloni

5.4.2. Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ-së në takimin e Rrjetit Zgjedhor të Rezistencës Kibernetike dhe Informacionit (CIREN), në Pragë, Çeki

5.6. Këshilli për Buxhet dhe Financa

5.6.1. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të shpenzimeve të derivateve për veturat e KQZ-së, për periudhën janar – shtator 2024

5.6.2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për blerjen e inventarit për KQZ-në

6. Të ndryshme !

1. Hyrie: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kryetari Radoniqi, pasqyroj agjendën e takimit. Pas paraqitjes së agjendës, Arianit Elshani kërkoi heqjen e pikave “ 5.1.2. Shqyrtimi dhe miratimi i Specifikave teknike për shtypjen e distinktivëve për procesin e Votimit për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025 dhe Zgjedhjet Lokale 2025.” Pastaj, të tërhiqet pika “5.1.4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të aktiviteteve për edukim dhe informim dhe materialeve të tjera”. Edhe një njoftim – pikë shtesë nga shërbimi votues: Bëhet fjalë për një memorandum me ministrinë e jashtme për votuesit jashtë Kosove. Pra, bëhet fjalë vetëm si njoftim. Ibrahim Selmanaj, kërkoi që lidhur me kërkesën e një zyrtari që ka kërkuar për kompensim shtesë, nuk i kemi kthyer përgjigje. Me dhanë një arsyetim, pra në mbledhjen e radhës kërkesa të shtrohet për shqyrtim.

Anëtarët e KQZ –së, miratuan me 10 vota rendin e ditës. Pastaj, në vazhdim u miratuna procesverbalet nr.58 dhe 59/2024.

2 Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ

Besnik Buzhala, u.d. i drejtorit të SKQZ, tha se në dy aktivitete: ajo e ndërrimit të qendrave të votimit, dhe periudha e aplikimit të votuesve jashtë Kosovës. Periudha e parë ka filluar më 29 gusht, dhe deri më 7 nëntor 2024, kanë kërkuar ndërrimin e QV-ve: 1524 votues. Prej tyre, 1071 janë parashtruar në mënyrë elektronike, dhe 353 përmes formularëve në zyrat e KKZ-ve. Periudha për aplikim të regjistrimit për Votim Jashtë Kosovës 14, 033 aplikime. Prej tyre, 13, 033 janë aprovuar, ndërsa janë refuzuar: 988 kërkesa. Raporti, përmban arsyet se pse janë refuzuar. Gjithashtu, janë paraqitur thirrje informative: 383 thirrje e mesazhe që kanë të bëjnë me mënyrën e regjistrimit. Në televizionin RTK, është duke vazhduar transmetimi për mënyrë e regjistrimit. Po ashtu, edhe platforma facebook, është funksionale. Në raport, janë analizat, raportet...

3. Aktivitetet e Zyrës

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për regjistrimin e partisë politike BASHKIMI DEMOKRATIK

Besnik Buzhala, drejtor i Zyrës paraqiti rekomandimin për regjistrimin e subjektit të ri politik "Bashkimi Demokrat". Ky subjekt me akronimin "BD", udhëhiqet nga Ajvaz Berisha. Ai, raportoi rrjedhën që nga aplikimi, e deri te kompletimi i dosjes, dhe paraqitjen në KQZ për regjistrim. Numri rendor, është: 54.

Zyra, rekomandon për regjistrim, tha në fund z. Buzhala.

Kreshnik Radoniq: A ka dikush diçka ? Nëse jo, kush është për...?

Me 10 vota për, u regjistrua ky subjekt më i ri politik me numër rendor 54.

4. Raport i Këshillave të KQZ

Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së Qendrave të Votimit:

Arianit Elshani: Këshilli, ka shqyrtuar listën e QV-ve ku do të zhvillohen votimet. Ne, besojmë që janë 944 qendra, por ka disa vështirësi. Mbyllja e disa qendrave është bërë për shkak të kushteve objektive: 1 shkollë në Kaçanik, 1 në Mitrovicë të Jugut dhe 1 në Leposaviq nuk janë aktive, janë të mbyllura dhe nuk mirëmbahen. Mirëpo, mund të adoptohen. Qytetarët përmes makinës kërkuese, të shohin se në cilat qendra ata duhet të votojnë ! Janë krijuar edhe qendra të reja të votimit qysh ma herët, dhe ata duhet ta shohin se në cilën qendër janë. Ftoj votuesit që të shohin se ku janë të alokuar. Në raport, janë të evidentuara edhe qendrat e votimit me kusht. Nuk është si më herët, tani kemi vetëm nga një qendër votimi me kusht. Kryeqyteti, që ka më shumë votues, do ta ketë qendrën e votimit me kusht në Fakultetin e Edukimit.

Rekomandojmë të miratohet kjo listë e QV-ve.

Anëtari Sami Kurteshi, shtroi pyetje shpjeguese rreth çështjes së qendrave me kusht, ndërsa z. Elshani e shpjegoi "historinë" e kësaj problematike. Ai, potencoi se në të kaluarën ka pasur deri në 28 mijë vota me kusht, mirëpo tani është me rëndësi që të sensibilizohet sa më shumë dhe qytetarët të njoftohen për rëndësinë e konfirmimit të tyre të qendrave të votimit. Edhe ne të bëjmë më shumë që ti njoftojmë qytetarët se ku janë qendrat e votimit me kusht, por me rëndësi është që qytetarët ta konfirmojnë qendrën e tyre të votimit dhe numri i votuesve me kusht të zvogëlohet sa më shumë.

Në këtë pikë, si për qendrat e votimit me kusht, si për çështjen e sigurimit të objekteve ku votohet, për sigurimin e vendvotimeve jo më larg se 3 kilometra etj. Ai tha se, KQZ ka nënshkruar memorandumet me gjithë kryetarët e komunave dhe aty janë shprehur qartë edhe obligimet ligjore të komunave lidhur me procesin, e ku hynë sigurimi i infrastrukturës. Shfrytëzoj rastin që, kryetarët e komunave ta kenë parasysh bashkëpunimin me KQZ.

Ilir Gashi: Duhet gjetur zgjidhje, dhe duhet pasur informim të veçantë për këto tri komuna dhe, qytetarët të njoftohen se ku ata tani duhet të votojnë në mungesë të objekteve të deritanishme.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i projektit- Fushatë ndërgjegjësuere për promovimin e barazisë gjinore në proceset zgjedhore:

Arianit Elshani: KOZ-i, tha z. Elshani e ka shqyrtuar edhe këtë pikë në takimin e vet. Si KQZ, kemi bërë disa analiza, kemi gjeneurue disa raporte nga zgjedhjet lokale dhe qendror të vitit 2021 lidhur me grup moshat, me barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e grave në trupat zgjedhore të KQZ. Ky aktivitetet duhet përfshijë këto dokumente dhe, ti adresoj të gjeturat dhe pastaj, në takimet ndërgjegjësuese ti inkurajojë gratë që të marrin pjesë në aktivitetet zgjedhore – trupat zgjedhorë, por edhe në rritjen e angazhimit të tyre në garën zgjedhore...Kuota gjinore në listat e partive, por tani edhe në trupat zgjedhorë është pjesë e fushatës së këtij projekti. Ne, rekomandojmë të miratohet..

Alban Krasniqi: Pse sot e kemi në agjendë, ka të bëj më shumë me afatet kohore, edhe OSBE që na mbështet ka azhuretet e saj. Miratimi i këtij dokumenti, duhet përfshijë edhe komentet tona, dhe shqyrtimet, kështu që ta kemi edhe njëherë projektin dhe të fillojë implementimi...
Me 10 vota për të anëtarëve, u miratua ky projekt.

3. Formimin i Këshillit për Informim Publik

Arianit Elshani: Në dy mbledhjet e fundit kemi diskutuar ne nevojën e formimit të Këshillit për Informim Publik. Ndryshe nga zgjedhjet tjera, konsiderojmë që ky këshill të përbëhet vetëm nga anëtarët e KQZ. Kjo, për shkak të efikasitetit të punëve...

Ne, jemi dakorduar të jemi: Unë, Alban Krasniqi, dhe Fazli Stollaj. Nëse nuk jeni kundër...!

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka kundër, ose diçka tjetër kush është për...?

Me 10 vota për, miratohet përbërja e Këshillit për Informim Publik prej: Alban Krasniqi, Arianit Elshani dhe Fazli Stollaj

4. Njoftim

Arianit Elshani: Në KOZ është diskutuar rreth një dokumenti. Fjala është për 'memorandumin' mes KQZ dhe Ministrisë së Jashtme lidhur me organizimin e votimit jashtë Kosovës. Kjo çështje,

tha z. Elshani, duhet të diskutohet dhe të intensifikohet përpilimi i draftit. Administrata, nuk është involvuar, as nuk kemi komente. Ne, po besojmë se deri të hënën do ta kemi një draft...

Ibrahim Selmanaj: Prej asaj që kemi pa dhe diskutua, shihet papërgjegjësia komunikuese. Dhe kur nuk ka komunikim, shprehen dobësitë, mungojnë sukseset...

Ilir Gashi: Duhet ta kemi një memorandum të zakonshëm. Ta bëjmë ne, pastaj ta dërgojmë. E trajtojmë kudo që është e nevojshme, dhe e miratojmë...

Sami Kurteshi: Dje e kam marrë tekstin, kam menduar që është trajtua! Këshilli ligjorë, mundet edhe njëherë me trajtua. Kurse, komunikimi i brendshëm, është mungesë e kulturës së bashkëpunimit. Tekstin duhet ta përfundojmë. Dhe KQZ, duhet ti dërgoj kërkesë që MPJ të i caktoj adresat e “Kutive Postare” për secilin shtet. Ta caktojmë një datë deri kur...

Në këtë pikë, diskutuan edhe: Alban Krasniqi, Qemailj Kurtis, Besnik Buzhala.

2. Këshilli për Personel

1. Njoftim lidhur me procesin e realizimit të rekrutimit për pozitat e përhershme dhe të përkohshme:

Alban Krasniqi: Çështja e parë është “njoftim” për pozitat e rekrutimit (pozitat e përhershme dhe të përkohshëm), dhe dokumentin – raportin e keni të bashkangjitur. Komentet mund ti adresojmë, mirëpo ajo cka mund të themi tani, është se rekrutimit në masën më të madhe janë duke u realizuar. Rekrutimi i stafit të përkohshëm, shkon mirë. Në fushën e IT-së, nuk ka sa duhet interesim, nuk janë atraktive...

Njësitë, kanë ngecje sepse nuk i kanë sjellë të gjitha përshkrimet e vendeve të punës. Por, megjithatë jemi në përgatitje të grupit 4, dhe të shohim se cilat pozita janë në radhë. Krahasuar me vitet e kaluara, niveli i rekrutimeve është më i vogël. Mendojmë se me më pak të angazhuar, jemi duke ia dalë, dhe kjo është në favor të kursimit të parasë publike.

Sidomos në KKZ-të, ka interesim të mjaftueshëm. Procesi është transparent. Mendojmë që do t jetë edhe kualiteti në nivel...

Sa u përket rekrutimeve permanente, tha z. Krasniqi, disa janë duke vazhduar: mendoj se është shpalla një pozitë në transport, dhe tjerat janë në proces. Nëse jo këtë vit, vitin tjetër duhet ta sigurojmë buxhetin me MEF, për 107 apo 108 punëtorë...

E keni raportin për periudhën aktuale.

Shqyrtimi dhe aprovimi i listës se kandidateve potencial për komision: Udhëheqësi i Njësisë për Regjistrim dhe Certifikim të Subjekteve Politike në ZRCKFSP:

Alban Krasniqi: Ky është obligim që rrjedh edhe nga ligji, edhe nga rregullorja jonë. Z. Krasniqi, citoi specifikat-kriteret për përzgjedhjen e komisionit. Ne, në personel kemi shqyrtuar këto kritere dhe ne rekomandojmë për aprovim.

Me 10 vota për, u miratua lista e kandidateve potencial për komision lidhur me këtë pozitë në Zyre.

Rekomandim për themelimin e grupit punues për sistemim dhe digjitalizim të arkivës së KQZ-së:

Alban Krasniqi: E kemi shqyrtuar këtë në personel, e keni draftin te vendimet që janë në sistem. Pse erdhi deri te ky draft – vendim ? Gjendja në arkivin tonë nuk është e mirë, dhe standardi nuk është adekuat si duhet. Duhet shfuqizua edhe rregulloren e deritashme, dhe ne e shohim të rëndësishme që ta autorizojmë drejtorin për një grup punues për sistemim dhe digjitalizim të arkivit. Grupi punues do të mbikëqyret nga Këshilli për Personel. Grupi, do të punojë mbi bazën e një kornize që, secili dokument të renditet, të klasifikohen dokumentet, të procedohen mbi afatin e tyre...

Është proces i gjatë, por duhet ta bëjmë. Dhe ne rekomandojmë për aprovim.

Sami Kurteshi, pyeti nëse kjo bëhet mbi bazën ligjore. Kjo duhet të bëhet, vetëm ta dimë se mbi cilin ligj, rregullore. A është një ligj, dhe ne duhet ta nxjerrim një vendim për shfuqizim të rregullores aktuale sado që i ka kaluar koha. Po, duhet të kemi parasysh se ne kemi arkiva jo veq këtu po në secilën KKZ. Dokumentet, materialet janë në gjendje të tmerrshme...

Qemal Kurtis, tha se arkiva është në gjendje të rrënueshme, madje disa materiale as nuk mund të shpëtohen, madje edhe mund të jen humbur materiale. Nuk duhet humbur kohë, kam parë se materialet janë në gjendje të keqe. Duhet të kemi vëmendje se nuk duhet të lejojmë këtë gjendje më tutje.

Diskutuan më tej: Arianit Elshani, tha se duhen veprime të shpejta sepse, situata është si është dhe ne duhet me urgjencë të marrim masa. E mbështesë formimin e grupit, miratimin...

Alban Krasniqi, pas shpjegimeve të duhura tha se rekomandimin që e kemi marrë, bashkë me dokumentet që na i ka paraqitur krye inspektorja e arkivave. Mund ti ndajmë, këtu është edhe baza ligjore. Dokumentet ja kemi përcjellë konsulentit tonë të mëhershëm, dhe ai ka shprehur gatishmërinë që të na ndihmoj deri në fund të procesit nëse do të jetë e nevojshme ose jo, do të nxjerrim një rregullore për arkivat...

Me rëndësi është lisitimi i dokumenteve, klasifikimi dhe ruajtja e tyre. Ne, duhet të konsultohemi, të marrim modele. Mirëpo, pa u aprovue lista unike e dokumenteve, më pas duhet të vazhdojmë me proceset, hapat e radhës...

Me 10 vota për miratohet themelimi i grupit punues për sistemim dhe digjitalizim të arkivës së KQZ-së.

Shfuqizimi i Udhëzimit Administrativ 02/2015 për Arkivin dhe Lëndët Arkivore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

Kreshnik Radoniqi: A ka diçka tjetër, apo po e miratojmë tani ?

Alban Krasniqi: Ky shfuqizim, është me propozimin e krye inspektores.

Pas shqyrtimit të përbashkët, anëtarët e KQZ me 10 vota për shfuqizuan Udhëzimin Administrativ 02/2015 për Arkivin dhe Lëndët Arkivore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

3. Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtari të kuvendit komunal

në Pejë:

Sami Hamiti, tha se në mbledhje të këshillit, është shqyrtuar kërkesa e kuvendit komunal të Pejës. Kërkesa ka ardhur pas dorëheqjes së asamblistit Sadri Berisha nga LDK. Kështu që, në vend të tij ne rekomandojmë këtë zëvendësim. Anëtari me radhë, Bekim Morina rekomandojmë të emërohet asamblistë në këtë komunë.

Anëtarët e KQZ, me 10 vota për miratuan këtë rekomandim për zëvendësim të asamblistit.

4. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ-së në konferencën “Informimi dhe angazhimi i votuesve – një perspektivë rajonale mbi sfidat dhe mundësitë për të rritur pjesëmarrjen në votime”, në Varshavë, Poloni:

Kreshnik Radoniqi, tha se kemi ftesë nga OSBE/ODIR. Ne, jemi dakordua që Fazli Stollaj dhe Myfera Shinik të marrin pjesë. Konferenca mbahet në anglisht, por do të ketë përkthim. Mbahet me 17-18 dhjetor 2024.

Me 8 vota për, u miratua ky propozim i KMJ.

Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ-së në takimin e Rrietit Zgjedhor të Rezistencës Kibernetike dhe Informacionit (CIREN), në Pragë, Çeki:

Kreshnik Radoniqi: E kemi edhe një ftesë. Por, është një vizitë që lidhet me aspektet teknike, dhe ne kemi menduar që të marrë pjesë Sekretariati. Ne, ta miratojmë pjesëmarrjen por që të vendosë Sekretariati. Ky takim, mbahet me 5 – 6 dhjetor.

Me 10 vota për, u miratua ky propozim i KMJ.

5. Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të shpenzimeve të derivateve për veturat e KQZ-së, për periudhën janar – shtator 2024:

Sami Hamiti: E kemi trajtua këtë pikë. Edhe unanimisht e kemi votue.

Alban Krasniqi: Kam ba do komente, mendoj që duhet të jenë përfshi.

Me 10 vota për, u miratua ky rekomandim.

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për blerjen e inventarit për KQZ-në:

(Kjo pikë u hoq nga rendi i ditës, dhe u shty të shqyrtohet edhe në këshillin për Personel)

6. Të ndryshme !

Kreshnik Radoniqi: Komitetin e Auditimit nuk e kemi funksional. Duhet ta shqyrtojmë këtë çështje sepse e kemi me ligj...

Sami Kurteshi: E kam informue KQZ kur ka kaluar mandati i përbërjes së kaluarës. Ne, i kemi kryer takimet, çështjet e ngritura... Mendoj se KO duhet të krijohet deri në fund të vitit. Është edhe një takim, por të shohim a mund të ngritët...

Alban Krasniqi: Auditori i brendshëm të merret me referencat, dhe mandej shohim procedurat...

